



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:136627

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05512603

E.nr.751/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje prej gjyqtarese përmbarese Elvira Emini, me bashkëpunëtorin profesional Visar Zeqiri, duke vendosur në lëndën përmbarese të kreditorit PTK sh.a me seli në Prishtinë, ndaj debitorës V. F. G. nga Lipjani, për realizimin e kërkesës në të holla në shumë prej 113.56.-€, në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarese shumë prej 15.00.-€, jashtë seancës gjyqësore, me datën 25.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura në këtë çështje përmbarese e kreditorit PTK sh.a me seli në Prishtinë, ndaj debitorës V. F. G. nga Lipjani, pasi që debitorët e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit në shumë prej 113.56.-€, në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarese shumë prej 15.00.-€.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kësaj gjykate E.nr751/11 të datës 09.08.2013, është caktuar përmbarese në dobi të kreditorit PTK sh.a me seli në Prishtinë, ndaj debitorës V. F. G. nga Lipjani, për realizimin e kërkesës në të holla në shumë prej 113.56.-€, në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarese shumë prej 15.00.-€, me ndalimin e mjeteve me para të cilat debitori i ka në llogarinë e tij dhe bartjen e kësaj shume në llogari të kreditorit, me regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit.

Ndërkohë që me parashtresën e datës 25.03.2024, të dorëzuar në mënyrë elektronike kreditori e ka njoftuar Gjykatën se debitori e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit, andaj e ka tërhequr propozimin ndaj të njëjtit.

Me dispozitat e nenit 66 par 4 të LPP-së, nr. 04/L-139 të datës. 20.12.2012, parashihet se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarese”.

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 66 par.4 të LPP-së, dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
Departamenti i Përgjithshëm
E.nr.751/11 me datën 25.03.2024

Gjyqtarja
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës e Apelit të Kosovës në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.